

VENDIM
NR.458, datë 8.7.2006

PËR “SHPALLJE DITË ZIJE KOMBËTARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002 “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre”, si dhe të pikës 8 kreu VI të vendimit nr.229, datë 23.4.2004 “Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, për të nderuar kujtimin e burrit të shquar të kombit, humanistit Pjetër Arbënorit, legjendës së qëndresës së njeriut për liri dhe dinjitet njerëzor, simbolit të sakrificës dhe triumfit të vlerave të lirisë, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen ditë zije kombëtare, ditën e dielë, datë 9.7.2006, në nderim të humanistit, të ndjerit Pjetër Arbënorit.
2. Në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike të ulet flamuri kombëtar në gjysmë shtize.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha